



KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.93 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359
Web: www.kolegjidardania.com



Në mbështetje të Ligjit Nr. 08/L-110 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Statutit të Kolegjit Dardania, Rregullores për Integritet Akademik, Kodit të Etikës dhe në përputhje me standardet evropiane për përdorimin e përgjegjshëm të teknologjive digjitale dhe inteligjencës artificiale në arsimin e lartë, Senati i Kolegjit Dardania, në mbledhjen e mbajtur më datë 13.09.24, miraton:

RREGULLOREN PËR PËRDORIMIN E INTELIGJENCËS ARTIFICIALE NË KOLEGJIN DARDANIA

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton parimet, standardet, kushtet dhe procedurat për përdorimin e sistemeve të Inteligjencës Artificiale (IA) në veprimtarinë akademike, shkencore, administrative dhe zhvillimore të Kolegjit Dardania.
2. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është:
 - 2.1. Të promovojë përdorimin etik, transparent dhe të përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale;
 - 2.2. Të mbrojtë integritetin akademik dhe shkencor;
 - 2.3. Të sigurojë mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidenciale;
 - 2.4. Të garantojë mbikëqyrjen dhe kontrollin njerëzor në përdorimin e sistemeve të IA-së;
 - 2.5. Të nxisë inovacionin dhe zhvillimin e kompetencave digjitale në komunitetin akademik.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për:
 - 1.1. Studentët e Kolegjit Dardania;
 - 1.2. Personelin akademik;
 - 1.3. Personelin administrativ;
 - 1.4. Bashkëpunëtorët e jashtëm dhe ekspertët e angazhuar nga Kolegji.

2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha sistemet dhe aplikacionet e Inteligjencës Artificiale që përdoren në kuadër të aktiviteteve të Kolegjit.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. **Inteligjencë Artificiale (IA - në tekstin e mëtejshëm)** – sistem i bazuar në teknologji kompjuterike që mund të gjenerojë, analizojë, klasifikojë, rekomandojë ose krijojë përmbajtje, vendime apo rezultate të tjera në bazë të të dhënave dhe algoritmeve.
2. **IA Gjenerative** – sistem që gjeneron tekst, imazhe, audio, video, kod kompjuterik ose forma të tjera të përmbajtjes.
3. **Përdorues** – çdo person që përdor sisteme të IA-së në kuadër të veprimtarive të Kolegjit.
4. **Transparencë** – detyrimi për të deklaruar përdorimin e IA-së kur ajo ka kontribuar në krijimin e përmbajtjes akademike ose profesionale.

KAPITULLI II **PARIMET THEMELORE**

Neni 4 **Parimet e Përdorimit të Inteligjencës Artificiale**

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në Kolegjin Dardania bazohet në këto parime:

1. Ligjshmëria;
2. Integriteti akademik;
3. Ndershmëria akademike;
4. Transparenca;
5. Përgjegjësia individuale;
6. Mbikëqyrja njerëzore;
7. Barazia dhe mos diskriminimi;
8. Mbrojtja e privatësisë;
9. Siguria e informacionit;
10. Respektimi i të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale.

Neni 5 **Përgjegjësia Individuale**

1. Inteligjenca Artificiale (IA) konsiderohet mjet mbështetës dhe jo zëvendësues i gjykimit profesional, akademik ose shkencor.
2. Përmbajtja e krijuar ose e përpunuar me ndihmën e IA-së mbetet përgjegjësi e plotë e personit që e përdor atë.
3. Asnjë rezultat i prodhuar nga IA nuk mund të konsiderohet automatikisht i saktë, i verifikuar ose i pranueshëm për përdorim akademik.

KAPITULLI III PËRDORIMI I IA-SË NË MËSIMDHËNIE DHE NË TË NXËNË

Neni 6 Përdorimi i Lejuar

Përdorimi i IA-së lejohet për:

1. Gjenerim të ideve dhe strukturim të koncepteve;
2. Përmirësimin gjuhësor dhe redaktimin e teksteve;
3. Përkthime dhe përpunim korrigjim gjuhësor;
4. Analiza paraprake të të dhënave;
5. Programim dhe testim të kodit;
6. Hartim të materialeve mësimore;
7. Mbështetje në proceset e kërkimit shkencor;
8. Zhvillimin e kompetencave digjitale.

Neni 7 Kategoritë e Përdorimit në Vlerësim

1. Personeli akademik përcakton në syllabuse njërën nga kategoritë e mëposhtme:
 - a) Përdorimi i ndaluar – IA nuk lejohet në asnjë fazë të detyrës apo vlerësimit;
 - b) Përdorimi i kufizuar – IA mund të përdoret vetëm për qëllime të caktuara të përcaktuara nga mësimdhënësi;
 - c) Përdorimi i lejuar – IA mund të përdoret si mjet mbështetës, me kusht që përdorimi të deklarohet dhe të respektohen kërkesat e integritetit akademik.
2. Mungesa e deklaramit të përdorimit të IA-së konsiderohet shkelje e integritetit akademik.

Neni 8 Deklarimi i Përdorimit të IA-së

1. Studentët dhe personeli akademik janë të obliguar të deklarojnë përdorimin e IA-së në çdo punim ku ajo ka kontribuar në mënyrë substanciale.
2. Deklarata duhet të përmbajë:
 - 2.1. Emrin e platformës ose mjetit të përdorur;
 - 2.2. Datën e përdorimit;
 - 2.3. Qëllimin e përdorimit;
 - 2.4. Përshkrimin e kontributit të IA-së.

KAPITULLI IV

INTEGRITETI AKADEMIK DHE KËRKIMI SHKENCOR

Neni 9

Parimet e Integritetit Akademik

1. Përdorimi i IA-së nuk duhet të cenojë:
 - 1.1. Origjinalitetin e punës akademike;
 - 1.2. Autenticitetin e rezultateve kërkimore;
 - 1.3. Besueshmërinë e publikimeve shkencore.
2. Autorësia akademike nuk mund t'i atribuohet kurrsesi një sistemi të Inteligjencës Artificiale (IA).

Neni 10

Përdorimi në Kërkimin Shkencor

1. IA mund të përdoret për:
 - a) Analiza të të dhënave;
 - b) Përpunim statistikor;
 - c) Organizim të literaturës;
 - d) Përkthim dhe redaktim gjuhësor.
2. Ndalohet:
 - a) Fabrikimi i të dhënave;
 - b) Manipulimi i rezultateve;
 - c) Gjenerimi i referencave të rreme;
 - d) Paraqitja e përmbajtjes së gjeneruar nga IA si rezultat origjinal kërkimor.

KAPITULLI V

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE SIGURIA E INFORMACIONIT

Neni 11

Mbrojtja e të Dhënave

1. Përdorimi i IA-së duhet të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Ndalohet ngarkimi në sisteme publike të IA-së i:
 - a) Të dhënave personale të studentëve;
 - b) Të dhënave personale të stafit;
 - c) Dokumenteve konfidenciale të Kolegjit Dardania;
 - d) Materialeve që përmbajnë informacione të mbrojtura me ligj.

Neni 12
Siguria Kibernetike

1. Përdoruesit janë të obliguar të përdorin vetëm platforma që ofrojnë standarde të pranueshme sigurie.
2. Zyra për Teknologji Informative monitoron dhe rekomandon mjetet e aprovuara për përdorim institucional.

KAPITULLI VI
SHKELJET DHE MASAT

Neni 13
Shkeljet

Shkelje të kësaj Rregulloreje konsiderohen:

1. Dorëzimi i punimeve të gjeneruara nga IA si punë personale;
2. Përdorimi i paautorizuar i IA-së gjatë provimeve;
3. Falsifikimi i rezultateve akademike ose shkencore;
4. Futja e të dhënave konfidenciale në sisteme të IA-së;
5. Mos deklarimi i përdorimit të IA-së.

Neni 14
Masat Disiplinore

1. Shkeljet trajtohen sipas akteve të Kolegjit Dardania për disiplinën dhe integritetin akademik.
2. Masat mund të përfshijnë:
 - a) Vërejtje me gojë;
 - b) Vërejtje me shkrim;
 - c) Anulim të detyrës ose provimit;
 - d) Procedurë disiplinore;
 - e) Masa të tjera të përcaktuara me Kodin Etik dhe me aktet tjera të Kolegjit Dardania.

KAPITULLI VII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional

1. Kolegji Dardania organizon programe të rregullta trajnimi për përdorimin etik dhe efektiv të Inteligjencës Artificiale.

2. Njësitë akademike të Kolegjit Dardania inkurajohen të integrojnë kompetencat për IA në programet studimore.

Neni 16
Interpretimi dhe Zbatimi

Për interpretimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj Rregulloreje përgjegjës është Komisioni për Integritet Akademik në bashkëpunim me Zyrën e Sigurimit të Cilësisë dhe Zyrën për Teknologji Informativ të Kolegjit Dardania.

Neni 17
Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Kolegjit Dardania.

KRYESUESI I SENATIT



Prof. Dr. Gjyldane Mulla